



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 945/2 prot.,

Datë 04.05.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-60471-02-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i rrugës “Grigor Cilka”* me fond limit 99,632,583.88 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: “Curri” SHPK.
Rr. “Kajo Karafili”, Nd.2, H., Ap.3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë
Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Në datën 03.05.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 945 protokollit e operatorit ekonomik “Curri” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-60471-02-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i rrugës “Grigor Cilka”* me fond limit 99,632,583.88 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Curri” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Curri” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 945 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik e financiar, pika 3, te dokumenteve standarte te tenderit ku percaktohet: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit)”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit, rezulton se operatori ekonomik Curri Shpk nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 dhe 2022. Operatori ekonomik Curri shpk, nuk plotëson pikën 8/8.2, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, të Dokumenteve Standarte të Tenderit ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument”, pasi nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik Curri shpk, nuk ka deklaruar për punonjësit Teknik ndertimi, elektrikist, hidraulik, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument. Operatori ekonomik Curri shpk, plotëson pikën 8.2, gërma” c” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, të Dokumenteve Standarte të Tenderit ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale” , pasi nuk është deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit numri dhe afati i vlefshmerise se deshmise se aftësisë profesionale për punonjësit Manovrator.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.05.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova